



**QËNDRA KOMBËTARE TEKNIKE  
BIO-MJEKSORE**

Nr. 2/5 Prot.  
Tiranë, më 31/12/22



**"ILLYRIAN GUARD" SHA**

Nr. 2670/4 Prot.  
Tiranë, më 29/12/2022

**KONTRATË SHËRBIMI**

**Titulli i kontratës:** Shërbim Sigurie për ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve dhe njerëzve të Qendrës Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore me punonjës shërbimi dhe sistem vëzhgimi dhe sinjalizimi.

*E lidhur më datë 31.12.22 ndërmjet palëve:*

**Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore**, me NIPT **K51731023B**, me adresë Rruga e Dibrës, Nr. 12, Tiranë, përfaqësuar nga **Z. Olton DHONO**, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, tani e tutje të referuar si "**Subjekti Përfitues i Shërbimit**"

*Dhe*

**Shoqëria "Illyrian Guard" ShA**, me adresë: Rruga "Ibrahim Rugova", Ish Garda e Republikës Shqiptarë, Tiranë, e cila është e organizuar dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar e Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT: L91619024U, me numër licence LN-7531-06-2019 për "Sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, të personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", përfaqësuar nga Administratori **Z. Robert LILI**, tani e tutje të referuar si **Ofruesi i Shërbimit**.

Referuar dispozitave të Kodit Civil të RSH, bazuar në Ligjin Nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" i ndryshuar, Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimi Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike", VKM-së Nr. 177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e Shoqërisë "Illyrian Guard" ShA, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 407/1, datë 14.06.2019 si dhe aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë fushë, bie dakort të realizojë shërbimin ashtu siç është specifikuar në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Formularin e Përgjegjësisë Profesionale





**QËNDRA KOMBËTARE TEKNIKE  
BIO-MJEKSORE**



**"ILLYRIAN GUARD" ShA**

3. Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e ofruesit të shërbimit për pagesë duhet t'i bëhet Përfituesit të Shërbimit me shkrim. Për çdo kërkesë, ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë origjinalin dhe kopje së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

**Neni 5**

**VONESA NË BËRJEN E PAGESËS**

1. Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e përfituesit të Shërbimit megjithëse ofruesi i shërbimit ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamat vonesave përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 6**

**KOHËZGJATJA E KONTRATËS**

1. Kohëzgjatja e kryerjes së shërbimit objekt i kontratës do të jetë **për një periudhë 12 mujore, 01.01.2023 me përfundim në 31.12.2023.**

**II. KUSHTET E KONTRATËS**

Kushtet e kontratës, përfshijnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**II.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS**

**Neni 7**

**QËLLIMI**

1. Kushtet e përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen nga palët kontraktore për blerjen e shërbimit objekt kontrate. Disa dispozita të Kodit Civil janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohn në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
2. Dispozita të Ligjit "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike" janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike.





**QËNDRA KOMBËTARE TEKNIKE  
BIO-MJEKSORE**

**“ILLYRIAN GUARD” ShA**

**Aneksi nr. 1**

1. Tabela e objekteve ku ofrohet shërbimi për Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore.
2. Rregullore e Përbashkët e Sigurisë së Objektivit.
3. Mënyra e llogaritjes së tarifës referuar Udhëzimit Nr.407/1 “Për mënyrën e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shoqëria “Illyrian Guard” Sh.A”.

**1. Tabela nr. 1**

**Objektet në ruajtje për llogari të Qendrës Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore:**

QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE BIO-MJEKËSORE										
Nr.	Objekt	VR	Turnet	Koha e ruajtjes	Koef.	Roje / Sistem	Tarifa mujore pa TVSH 1 roje/sistem elektronik	Vlera Totale Mujore pa TVSH	Vlera totale vjetore pa TVSH	Vlera totale vjetore me TVSH
1	Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore	1	1	8 ore nga e hena ne te premtë	1.18	1.18	71.243,00 Lekë	84.066,74 Lekë	1.008.800,88 Lekë	1.210.561,06 Lekë
				24 ore nga e hena ne te diele		1	190.206,00 Lekë	190.206,00 Lekë	2.282.472,00 Lekë	2.738.966,40 Lekë
<b>Vlera totale e kontratës</b>						<b>punonjës shërbimi / sistem elektronik</b>	<b>274.272,74 Lekë</b>	<b>3.291.272,88 Lekë</b>	<b>3.949.527,46 Lekë</b>	

*Handwritten signature*





**QËNDRA KOMBËTARE TEKNIKE  
BIO-MJEKSORE**



**“ILLYRIAN GUARD” ShA**

**Aneksi nr. 4 - Proces Verbali i marrjes së objekteve në dorëzim me fillimin e zbatimit të kontratës**

Tiranë, \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_

**Proces Verbal**

Për marrjen dhe dorëzimin në ruajtje të objektit \_\_\_\_\_.

Objekti merret në dorëzim për ruajtje prej orës \_\_\_:\_\_\_ dt. \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_.

Objekti merret në ruajtje sipas Kontratës së dakortësuar ndërmjet \_\_\_\_\_ dhe “Illyrian Guard”sha. Ruajtja do të bëhet me \_\_\_\_\_ (organizimi i shërbimit).

Objekti u kontrollua nga dorëzuesit dhe marrësit në ruajtje. Nuk ka probleme në objekt. Ndërtesat e Institucionit janë të mbyllura. Vendrojet e qëndrimit të punonjësve të shërbimit janë të rregullta për kryerjen e detyrës.

Ky proces verbal mbahet në tre kopje, nga një për çdo përfaqësues.

**Processverbali firmoset nga tre përfaqësues:**

**Marrësi**

**Dorëzuesi**

**Institucioni**

Illyrian Guard sha

Emër Mbiemër

Emër Mbiemër

Emër Mbiemër



**QËNDRA KOMBËTARE TEKNIKE  
BIO-MJEKSORE**



**“ILLYRIAN GUARD” ShA**

**Aneksi nr. 5 - Proces Verbali mujor i kryerjes së shërbimit**

**PROCES VERBAL**

**Për kryerjen e shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike në Objektin \_\_\_\_\_ për muajin \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_**

**Referuar:**

- Kontratës Nr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ ndërmjet \_\_\_\_\_ dhe Shoqërisë "Illyrian Guard" sh.a në lidhje me realizimin e shërbimit Ruajtja dhe Siguria Fizike e Objekteve dhe ambienteve të institucionit.
- Ligjit Nr.75, datë 10.07.2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike"
- Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 "Për Funkionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike".
- Rregullores së përbashkët ndërmjet Shoqërisë "Illyrian Guard" sh.a dhe \_\_\_\_\_.

Për periudhën prej \_\_\_\_\_ deri \_\_\_\_\_ është kryer shërbimi nga ana jonë sipas Kontratës dhe Rregullores së nënshkruar mes Shoqërisë "Illyrian Guard" sh.a dhe KLG

**Nga ana e shoqërisë shërbimet janë kryer me profesionalizëm dhe kopetencë. Janë respektuar termat dhe kushtet e përcaktuara mes subjekteve tona.**

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë ngjarje për tu shënuar/ janë shënuar këto probleme dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura proceduriale.

**Dokumentacioni:** Librat e planizimit dhe marrjes dhe dorëzimit të shërbimit që gjenden në vendroje të plotësuar gjatë kryerjes së shërbimit.

Proces verbali mbahet në dy kopje. Një kopje për institucionin që merr shërbimin dhe një kopje për shoqërinë "Illyrian Guard" sha.

**PËRFAQËSUESIT**

**EMËRTIMI I INSTITUCIONIT**

**Ismail Garipi**

\_\_\_\_\_  
**Personi i autorizuar për ndjekjen e kontratës**

**SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD”**

**SHA**

**Qamil ABEDIN**

\_\_\_\_\_  
**Drejtues Teknik 1.3.A**